



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
GJYKATA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Data

06. 12 20 18

Numri i lëndës: 2018:053674

Datë: 25.10.2018

Numri i dokumentit: 00157602

P.nr.202/13

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me procesmbajtësen Marigona Shaqiri , në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-se dhe nenit 253 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore Ferizaj PP.nr.598/2010 e dt.25.03.2011, dhe PP/II.nr.2111-7/15 e datës 07.04.2016 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me date 09.03.2018, 12.07.2018 dhe 17.09.2018 , në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurores Mimoza Sylta të akuzuarit [REDACTED], në të njëjtën ditë mori dhe me date 18.09.2018 publikisht shpalli, kurse me dt.25.10.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari, [REDACTED] nga Lipjani rr. e [REDACTED], i lindur me date [REDACTED] në fshatin [REDACTED], komuna e Shtimes, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, kinse i padënuar me parë, mbrohet në liri

Ë SHTË FAJTOR

SEPSE:

Me date 04.02.2010 ne intervalin kohor prej orës 16:45 e deri ne ora 18:50 ne rr."Bajram e Gursel Sylejmani",me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te luajtshme dhe qe vetes t'i sjelle përfitim pasuror ne mënyrë te kundërligjshme ka vepruar ne atë mënyrë qe me një mjet te forte dhe te papërshtatshëm e ka hapur derën e terases dhe ka depërtuar brenda ne shtëpi, ku nga aty ka marre nje televizor plazma e tipi "Samsung" ne vlere rreth 400 euro, 3 teledirigjues ne vlere prej 30 euro dhe dy zingjir qafe si dhe katër unaza prej ari ne vlere prej 300 eurove, prone e te dëmtuari [REDAKTUAR] dhe largohet nga vendi i ngjarjes,

-me të cilën ka kryer veprën penale Vjedhje e Rëndë nga neni 253 par.1 nën par. 1, te KPK-së.

Me date 10.01.2015, rreth orës 18:30, ne fshatin Davidovc, komuna e Shtimes, ne shtëpinë e te dëmtuarit [REDAKTUAR] me qellim te përvetësimit te sendeve te huaja te paluajtshme dhe qe vetes t'i sjelle dobi pasurore ne mënyrë te kundërligjshme me force kishte hapur dritaren e shtëpisë, kishte depërtuar brenda ne shtëpi ku me këtë rast kishte demoluar shtëpinë, por nuk kishte gjetur asgjë me vlere me c'rast është larguar nga aty pa marre asgjë,

me te cilën kreu veprën penale "vjedhje e rende" nga neni 327 par. lidhur me nenin 28 te KPRK-se.

Ne baze te neneve 3,5,11,15,34,38,dhe 64 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosoves dhe nenit 365 te KPPK-se e,

G J Y K O N

- I. Te akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj, i cili dënim duhet te ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- II. Te dëmtuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ne pajtim me dispozitat nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

- III. Konform dispozitave të nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së. Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumen prej 30/tridhjetë/ euro në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguajë shumen prej 30/tridhjetë/ eurove në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par 1.1 të KPPK-ës.

II

REFUZOHET AKUZA

Se me datë 10.01.2015, rreth orës 18:30, në fshatin Davidovc, komuna e Shtimes, në shtëpinë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të paluajtshme dhe që vetes t'i sjelle dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme me forcë kishte hapur dritaren e shtëpisë, kishte depërtuar brenda në shtëpi ku me këtë rast kishte demoluar shtëpinë, por nuk kishte gjetur asgjë me vlerë me c'rast është larguar nga aty pa marrë asgjë,

Megjithatë prokurori i shtetit, është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat PP.nr.598/2010 e dt.25.03.2011, dhe PP/II.nr.2111-7/15 e datës 07.04. ka akuzuar [REDAKTUAR] për veprën penale Vjedhje Rende nga neni 253 par.1, nenpar.1 të KPK.

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 245 të KPPRK-se ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 09.03.2018, shqyrtimin gjyqësor me datë 17.09.2018. Gjykata

pasi ka vërejtur se veprat penale janë kryer nga i njëjti person, si dhe pasi ka vërejtur se veprat penale kanë lidhshmëri me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 35.par.1 i KPPRK-se për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedure gjykata vendosi për bashkimin e procedurës për veprat penale si dhe për akuzat e lartë cekura, ku në të ardhmen do të udhëhiqen me numrin me të vogël P.nr.202/13.

Në hapjen e shqyrtimit gjyqësor, gjyqtarja konstatoi se janë plotësuar të gjitha kushtet për të mbajtur shqyrtimin gjyqësor në kuptim të nenit 305 të KPPRK-se, me pastaj gjyqtarja e udhëzoi të akuzuarin në kuptim të nenit 246 par.1 i KPPK-se, dhe çmoi se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar. Me pas Prokurorja i ka lexuar të akuzuarit aktakuzën dhe pasi që gjykata është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka ofruar të drejtën të deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij për veprën penale për të cilën akuzohet, me c'rast i akuzuar si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar nga prokuroria.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare sa i përket dispozitivit të aktakuzës PP.II.nr 598/2010 ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues kundër [REDAKTUAR] pasi që gjatë administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe pas leximit të deklaratave të dëshmitareve [REDAKTUAR] dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe duke u bazuar në raportin të oficerit të dt. 04.02.2010, fotografitë dhe shkresat e tjera që gjenden në dosjen e lëndës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuzë, andaj i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal në pajtim me ligjin.

Pasi që Prokurorja e Shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën penale sipas aktakuzës PP/II.nr.2111-7/15, gjykata duke u bazuar në nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-se vendosi që të akuzuarin ta lirojë nga akuzat, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

I akuzuari [REDAKTUAR] si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se e kundërshton aktakuzën dhe se nuk e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet duke kërkuar nga gjykata që nëse shpallet fajtor t'i shqiptojë dënim maksimal.

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe në shqyrtimin gjyqësor për asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktgjykimi për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. nenpar.1 i KPK-se (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), gjykata me qellim të vërtetimit të drejte dhe të plote të gjendjes faktike ka shqyrtuar dhe administruar secilën prove veç e veç dhe të ndërlidhura ne mes vete.

Gjykata gjendjen faktike si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka vërtetuar ne baze të provave të paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit,
- Nga dëshmia e të dëmtuarit –dëshmitarit [REDACTED]
- Nga deklarata e të akuzuarit dhënë ne polici e datës 10.04.2010 dhe
- Nga shikimi i fotografive dhe shkresave të tjera të lendes.

I akuzuari ne mbrojtjen e tij ka theksuar se i kujtohet shume mire dhe se është shume i sigurt se ne ditën kritike me date 04.02.2010 ka qene ne vuajtje të dënimit ne Mal të Zi dhe atë ne burgun e Spugjes dhe ka deklaruar se këto pretendime të tij mund të i dëshmojë edhe me prova, ndërsa kur Prokurorja e ka ballafaquar me deklaratën që i akuzuari e ka dhënë ne polici me date 10.04.2010, ai ka mohuar se ka dhënë dhe ka nënshkruar një deklaratë të tillë. Këto pretendime të të akuzuarit gjykata i vlerësoi si të pavërteta dhe të pabazuara ngase nuk përputheshin me deklaratën e dhënë nga i akuzuari ne polici, po ashtu këto pretendime nuk mund të vërtetoheshin me asnjë prove konkrete dhe kishin për qellim fshehjen e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit, prandaj këtyre deklarimeve gjykata nuk u shprehi besimin e plote.

Sa i përket dëshmitarit- të dëmtuarit [REDACTED] ne shqyrtimin gjyqësor është bere leximi i deklaratës se tij pasi që për te njëjtin gjykata përmes telefonit nga ana e policisë dhe ne baze të fletë kthesës është njoftuar se i njëjti gjendet jashtë vendit dhe atë ne Gjermani, prandaj prokurorja propozoi që te behet leximi i deklaratës se dëshmitarit dhe ky propozim u pranua nga ana e gjykatës dhe te pandehurit.

Ne deklaratën e datës 04.02.2010 me nr. 2010 CF 225 i dëmtuari-dëshmitari [REDACTED] kishte deklaruar se ne te njëjtën date rreth orës 16:45 ka dale nga shtëpia, e ka mbyllur derën dhe se ne shtëpi nuk ka qene askush, por kur është kthyer rreth orës 18: 50 ka vërejte se

dera e terases ishte e hapur dhe se dikush i panjohur kishte hyre ne shtëpi nga ku kishte marre një televizor plazma ne vlere 400 euro, dy zingjir ari me vlere rreth 100 euro si dhe disa unaza qe nuk e di vlerën e tyre. Këtë dëshmi gjykata e vlerësoi si reale, te pranueshme dhe te mbështetur ne faktet, fotografitë, shkresat si dhe provat e tjera qe gjenden ne shkresat e lendes, prandaj dëshmisë se dëshmitarit ne fjale gjykata i shprehi besimin e plote.

Ne deklaratën e dhënë në procedurën hetimore me date 10.04.2010 me nr.2010-CF-0225 i akuzuari e ka pranuar se ne ditën kritike ne rrugën e Varoshit ka qene tek shtëpia e te dëmtuarit [REDAKTUAR], por sipas pretendimit te te akuzuarit ai nuk ka qene vetëm, por së bashku me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Prishtina duke shtuar se këta tre persona nga shtëpia e te dëmtuarit kane marre një televizor plazma, tre dirigjues, dy zingjir dhe dy unaza dhe se ky i ka pritur ne veture, me pastaj ata se bashku kane shkuar ne Prishtine me c'rast [REDAKTUAR] i ka shitur sendet dhe për vete ka ndale shume 400 euro, kurse te tjerëve u ka dhënë shumen prej 40 eurove.

Këtë deklaratë te te akuzuarit gjykata e vlerësoi si pjesërisht te bazuar ngase nuk gjeti prova te mjaftueshme te cilat inkriminojnë apo përfshinë edhe personat e përmendur ne kryerjen e kësaj vepre penale. Me tutje pohimin e te akuzuarit se veprën e kane kryer te lartpërmendurit e jo i akuzuari gjykata e vlerësoi si jo real dhe te pabesueshëm ngase nuk është provuar me asnjë prove konkrete duke vlerësuar se ky pohim ishte i drejtuar ne fshehjen e veprimeve inkriminuese dhe lehtësimin e shkalles se përgjegjësisë penale për te akuzuarin.

Gjykata pasi analizoi dëshmitë e dëshmitareve dhe pasi vlerësoi te gjitha provat qe gjenden ne shkresat e lendes gjeti se ne veprimet e te akuzuarit hasen te gjitha elementet objektive dhe subjektive te veprës penale vjedhje e rende nga neni 253 par.1 nenpar.1 te KPK.

Me rastin e matjes se lartësisë se dënimit gjykata mori parasysh te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 64 paragrafi i 1 i Kodit te Përkohshëm Penal duke marre si rrethane lehtësuese gjendjen e dobët ekonomike e sidomos faktin se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohe e gjate përafërsisht tete (8) vite. Ndërsa sa u përket rrethanave renduese gjykata ka gjetur se i akuzuari është duke në e vuajtur dënimin me burgim ne Burgun e Sigurisë se Larte pasi qe është dënuar me aktgjykim te formës se prere për veprën penale te vrasjes andaj duke marre parasysh këto rrethana gjykata ka konkluduar se edhe me dënimin e shqiptuar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi do te arrihet qëllimi i dënimit ne kuptim te preventives gjenerale dhe speciale.

Ndërsa sa u përket rrethanave renduese gjykata pas verifikimeve te nevojshme nuk gjeti ndonjë rrethane renduese veçse e vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale te te akuzuarit.

Sa i përket pjesës së dytë (II) të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues, Prokurorja e shtetit ne fjalën përfundimtare ka theksuar se tërhiqet nga ndjekja penale për veprën penale sipas aktakuzës PP/II.nr.2111-7/15, sepse gjate shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar me asnjë prove se i akuzuari e ka kryer veprën penale me te cilën është akuzuar sipas kësaj aktakuze dhe po ashtu këto pretendime prokurorja i mbështetet edhe ne deklaratat e te dëmtuari [REDACTED] dhe ne dëshminë e dëshmitarit [REDACTED], ngase edhe sipas deklaratave te këtyre dëshmitareve nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale sipas aktakuzës ne fjale.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,

P.nr.202/13 datë 25.10.2018

Procesmbajtëse

Marigona Shaqiri

Gjyqtarja

Hakile Ilazi



KËSHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit me shkrim të kopjes se këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj.